



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2022:151487
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05605942

CPK.nr.17/24
P.nr.472/22

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Dega Novobërdë , Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit G.A, në çështjen përmbarimore të kreditorit “I.C” J.S.C”, me seli në P. Rruga “U. H”, nr,49/1,të cilën e përfaqëson M.G av. nga Lipjani, kundër debitorit D. /S./ S nga fsh. S. Komuna N.duke vendosur lidhur me ushtrimin e prapësimit të debitorit të datës 03.04.2023, ndaj Urdhërit Përmbarimor P.nr.472/22 i dt. 08.09.2022, të Përmbaruesit Privat B. T. nga F. jashtë seancës më 23.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i datës 03.04.2023, i debitorit D. /S./ S. nga fsh. S. Komuna N. të paraqitur kundër Urdhërit P.nr.472/22 i dt. 08.09.2022, të Përmbaruesit Privat B.T. nga Ferizaji.

II. Mbetet në fuqi Urdhërit Përmbarimor, P.nr.472/22 i dt. 08.09.2022 të Përmbaruesit Privat.

A r s y e t i m i

Përmbaruesit B. T. nga Ferizaji, me Urdhërit Përmbarimor P.nr.472/22 i dt. 08.09.2022, ka lejuar përmbarimin , në mes të “I.C” J.S.C”, me seli në Prishtinë , kundër debitorit D. /S./ S. nga fsh. Strazh Komuna N. për shkak të pagesës së borgjit në shumën prej 1,783.78€, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, në bazë të Kontratës mbi Kreditin nr.148967, Marrëveshjes mbi Pengun të datës 22.11.2019, si dokumente përmbarimore – titull ekzekutivbazuar në nenin 22 të LPP-së.

Debitori më dt.03.04.2023, ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar urdhërin përmbarimor të lejuar nga përmbaruesi privat . Më tej ka shtuar se urdheri është i perfshirë në shkeljen thelbësorë të dispozitave të LPP-së, për shkak se debitorit nuk ia jan dorzuar asnjera nga provat e përmendura në propozim. Është e vërtetë se debitori ka marr kredi me vlerë 1200.00 euro , mirëpo me rastin e nenshkrimit nuk ka marrë asnje kontrat apo ndonjë udhezim, se si ti

kthej të hollat e marra , dhe si ti paguaj ato, e në cilën bank. Dokumentet ishin në gjuhën shqipe, të cilën gjuhë debitori nuk e ka kuptuar dhe se nuk e ka ditur se çka po nënshkruan .

Përmbartuesi privat nuk ka pasur të drejtë që të lejoj përmbartimin, sipas kontratës mbi huan dhe marrëveshjen mbi hipotekë me nr.148967, pasi që nuk janë dokumente të rregullta apo janë të falsifikuara dhe si dokumentacion nuk i është dorëzuar fare debitorit .

Debitori e kundërshton edhe kamatën në vlerë 73.20 %, e që është në kundërshtim me nenin 382 të LMD-së, ku kamata është 8%. Pranojm ta paguajm shumë prej 1200 euro , me kështu , ndërsa nuk pranojm shumën 1783,78 euro .

Në fund gjykates i ka propozuar që të merr akvendim me të cilën ta refuzoj prapësimin dhe ta shfuqizoj urdherin për përmbartim , dhe lënda të kthehet përsëri në rishqyrtim.

Kreditori me datën 05.04.2023 , përmes përfaqësueses së saj ka ushtruar përgjegje në prapësim, duke theksuar se i kundërshtojm në tërësi theniet e debitorit, pasi që ushtrimi i prapësimit është vetëm një tendencë për ta zvarritur procedurën pasi që propozimi për përmbartim është nxjerrë bazuar në dokumentin përmbartor të parapara sipas nenit 22 të LPP-së, sic janë kontrata mbi kredinë dhe kontrata mbi pengun, e që i'u janë bashkangjitur propozimit për përmbartim .

Dokumentet përmbartimore janë të përshtatshme për përmbartim pasi që përmbajnë të gjitha elementet sipas ligjit .

Kundërshtoj pretendimin e debitorit, se propozimi për përmbartim duhet të bashkangjiten kopjet e kontratave për palën debitore, pasi që kreditori i ka dërguar përmbartuesit privat të gjithë dokumentacionet e kërkuar sipas ligjit për të udhëhequr procedurën përmbartimore.

Gjithashtu kundërshtojm theniet e debitorit sa i përket lartesisë së borxhit, si të pa bazuar pasi që me vetë faktin se pala debitore ka qenë e obliguar të përmbushë obligimet brenda afatit të caktuar , e që ajo nuk i ka përmbushur e se i njëjti është në vonë, andaj kjo shumë është llogaritur drejt nga pala kreditore .

Në fund gjykates i ka propozuar që ta refuzoj prapësimin e debitorit të dt. 03.04.2023, si të pa themel të, dhe ta vërtetoj urdherin përmbartor të përmbartuesit privat P.nr.472/22 i dt. 08.09.2022.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës vërtetoi se prapësimi i debitorit i ushtruar më dt.03.04.2023, është i pabazuar për shkak se i njëjti nuk gjen mbështetje në shkaqet e prapësimit siq parasheh neni 71 i LPP-së, për shkak se Kontrata specifike Huaje Personale në kuadër të Kontratës mbi Huanë – kushtet e përgjithshme me nr.148967 të dt . 22.11.2019.

Në bazë të të cilave është ushtruar propozimi për përmbartim e më pas është lejuar edhe Urdhëri Përmbartor nga përmbartuesi privat janë dokumente përmbartimore – titull ekzekutiv, konform nenit 22 paragrafi 1, pika 1.7 të LPP-së, si dhe si dhe sipas neneve 166 dhe 167 të LPDS-se, ku është paraparë ekzekutimi i pengut.

Sipas njoftimit të lëshuar nga BQK-ja, e dt.11.12.2019 sipas pikës 5 të njoftimit ku janë njoftuar të gjithë klientet e kreditorit se në asnjë rrethanë Vendimi Mbi Revokimin e Licencës së Kreditorit të dt.06.12.2019 nuk nënkupton lirimin e klienteve nga obligimet për të paguar kredite e lejuara, ku edhe është kërkuar nga klientet që të vazhdojnë të paguajn obligimet kreditore sipas afatave të percaktuara në kontratat e kredive, e në të kundërtën do të inicohet procedurë gjyqësore me qëllim të inkasimit të borxheve .

Gjithashtu pretendimi i debitorit se nuk ka qenë në dijeni se ku mund të paguhen këstet e kredisë nuk qëndron pasi që në faqen e parë të kontrates është percaktuar edhe mundësia e pageses së kësteve, sipas planit të pagesave në bankat si në vijim NLB Bank, TEB Bank dhe BKT Bank .Në kontraten e kredisë është paraparë edhe norma efektive e interesit në shkallen prej 73.20% në vit , andaj sipas 383 të LMD-së është paraparë “*Kreditore dhe debitori mund të pajtohen me kontratë që lartësia e kamatëvonesës të jetë më e ulët ose më e lartë sesa niveli i kamatëvonesës së percaktuar me ligj*”. Andaj në rastin konkret debitori është pajtuar që kamatëvonesa të jetë në shkallen 73.20% në vitë.

Nga të cekurat e mësipërme e në pajtim me nenin 22, 23, 70, 71 ,72 dhe 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
CPK.nr.17/24, Datë 23.04.2024

Gjyqtari
G.A

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes Gjykatës Themelore në Gjilan.